



THIRRJE  
E HAPUR



DOKU.TECH

## PËR STUDENTËT E ARTITEKTURËS




IPKO Foundation është organizatë, e cila mbështetë zhvillimin e gjeneratave të ardhshme të liderëve, të cilët përdorin teknologjinë për të implementuar zgjidhje inovative për sfidat lokale dhe nacionale, duke mundur kështu një mjedis ku ata mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë përmes një konteksti më të qashtëm institucional.

Që nga viti 2014, Organizata IPKO Foundation sjell në Kosovë një ndër konferencat e teknologjisë më me renome në Ballkan - DOKU.TECH, e cila këtë vit do të shënojë edicionin e 9-të me radhë. IPKO Foundation shpreh interesim që të angazhojë një apo më shumë studentë të përkushtuar të Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin e Prishtinës, i cili/të cilët do të kenë mundësi që për një periudhë të caktuar kohore të punojnë me ekipin e IPKO Foundation për organizimin e hapësirës së Termokiss-it për DOKU.TECH 2022.

Çka përfitojnë studentët e përzgjedhur?

- Angazhimi në një nga konferencat më me renome të teknologjisë në Ballkan, DOKU.TECH, do t'ju ofrojë një përvojë të re, jashtëzakonisht profesionale, e cila do të zgjerojë rrjetin tuaj të bashkëpunëtorëve potencial në të ardhmen.
- Përfitoni certifikata dhe referenca nga një organizatë kredibile si IPKO Foundation, të cilat do t'i shfrytëzoni për angazhime profesionale në fushën tuaj të studimit.
- Do të përfitoni kuponë nga A.U.K - Training and Development Institute për mbajtjen FALAS të trajnimeve nga fusha specifike në të cilat ju shprehni interes.
- Ne do t'ju mbulojmë shpenzimet e transportit dhe ushqimit për periudhën kohore që do të jeni të angazhuar, si dhe,
- Me automatizëm do t'ju zgjedhim vullnetarë të edicionit të 9-të të konferencës së teknologjisë DOKU.TECH



Preferohet që studentët e angazhuar të jenë në vitin e tretë të studimeve në Fakultetin e Arkitekturës. Ne ju inkurajojmë që ju të formoni një grup deri në 4 studentë dhe të shprehni interesimin tuaj në e-mailin: [info@ipkofoundation.org](mailto:info@ipkofoundation.org) jo më larg se të dielën, 24 Prill, 2022, 23:59, me një email në subjektin e së cilës shkruani "DOKU.TECH 2022 - shprehje e interesimit nga studentë të Arkitekturës". Për çdo pyetje shtesë ose paqartësi që mund të kenë na shkruani në e-mailin e mësipërm apo na kontaktoni në numrat vijues: +383 (0) 48 808 071 ose +383 (0) 49 196 655